



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës  
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

---

## **BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE**

**Prill, 2026**

## PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Numri i rasteve dhe vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse gjatë muajit mars 2026
2. Sëmundjet ngjitëse të raportuara në Kosovë, forma e agreguar dhe individuale
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

### QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

### **1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT MARS 2026**

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar 10,391 raste me sëmundje ngjitëse Inc.(648.42 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (18,760 raste apo Inc 1,052.28 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Influenca sezonale (ILI) me 4,785 raste ose Inc. 298.59/100,000, Diare ac. me 3,455 raste ose Inc. 215.60/100,000 banorë dhe ARI/ITPR me 1,300 raste ose 81.12 në 100,000 banorë (Tab.1).

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar 5 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 3 raste me Infiltratio Pulmonum me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me diagnozë Gastroenterocolitis acuta me diagnozë përcjellëse.

**Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuara në Kosovë, mars 2026 krahasuar me mars 2025**

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuara në Kosovë, 01 – 31 mars të vitit 2026 dhe 2025				
Sëmundjet/shkaktarët	mars, 2026		mars, 2025	
	Nr. i rasteve	Incidenca/100,000	Nr. i rasteve	Incidenca/100,000
COVID-19	1	0.06	0	0.00
ITPR - Pneumonia/ARI	1300	81.12	1876	105.27
SARI (infeksion i rëndë akut respirator)	39	2.43	19	1.07
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	4785	298.59	12517	702.37
Influenca A	1	0.06	21	1.18
Influenca B		0.00	44	2.47
RSV	21	1.31	15	0.84
Diarea akute	3455	215.60	3673	206.10
Variçela	507	31.64	371	20.82
Sindromi meningjeal	17	1.06	13	0.73
Helmimet me ushqim	96	5.99	19	1.07
Salmonella enteritidis	2	0.12	5	0.28
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale me Rotavirus	14	0.87	13	0.73
Gastroenterokolitet	14	0.87	30	1.68
Cl.difficile	3	0.19		
Hepatiti akut B	1	0.06	4	0.22
Hepatiti akut C	1	0.06		0.00
Morbilli		0.00	3	0.17
Parotiti epidemik	2	0.12	1	0.06
Pertussis	3	0.19	3	0.17
Rubeolla		0.00	1	0.06
Tularemia		0.00	1	0.06
Brucellosis	2	0.12	5	0.28
Sëmundja Lyme		0.00	2	0.11
TB	51	3.18	81	4.55
HIV	3	0.19	2	0.11
IST	14	0.87	18	1.01
Giardiaza	13	0.81		0.00
Infeksionet strptokoksike të grupit A	23	1.44		
*Sëmundjet tjera ngjitëse	23	1.44	23	1.29
<b>Gjithsej</b>	<b>10391</b>	<b>648.42</b>	<b>18760</b>	<b>1052.68</b>

\*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

## 1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, MARS 2026

### Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

**Influenca sezonale /ILI:** Gjatë muajit mars 2026 në IKShPK janë raportuar 4,785 raste me ILI (Inc. 298.59/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet një ulje prej 61.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (12,517 raste të raportuara). Gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, shkurt 2026 me (5,750 raste të raportuara me ILI) vërehet një ulje prej 16.8%. Megjithatë, pavarësisht rënies, numri i rasteve të raportuara i atribuohet faktorëve si qarkullimi i viruseve respiratore, përfshirë virusin e gripit dhe patogjenët tjerë respiratore.

**Diarea akute:** Gjatë muajit mars 2026 në IKShPK janë raportuar 3,455 raste me diare akute (Inc. 215.60/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (3,673 raste), vërehet një ulje e lehtë prej 5.9% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak shkurt 2026, me 3,460 raste të raportuara, afërsisht numër i njëjtë i rasteve të raportuara. Numri i rasteve të raportuara me diare akute mbetet shqetësues për shëndetin publik, marrë prasysh ekspozimin e vazhdueshëm të popullatës ndaj patogjenëve të ndryshëm ushqimorë dhe atyre përmes ujit, veçanërisht kushtet e ruajtjes dhe përgatitjes së ushqimit.

**ARI/ITPR:** Gjatë muajit mars 2026 në IKShPK janë raportuar 1,300 raste me ARI (Inc. 81.12/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,876 raste) vërehet një ulje prej 30.7% e rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak shkurt 2026 me (864 raste) vërehet rritje e numrit të rasteve. Numri i rasteve të raportuara lidhet kryesisht me sezonin e infeksioneve respiratore, temperaturat e ulëta si dhe rritjen e ekspozimit në ambiente të mbyllura, duke favorizuar përhapjen e patogjenëve respiratorë.

**Variçella:** Gjatë muajit mars 2026 në IKShPK janë raportuar 507 raste me Variçellë (Inc. 31.64/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (371 raste) vërehet rritje prej 36.6% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak shkurt 2026 me 356 raste të raportuara, rritje prej 42.4% e numrit të rasteve të raportuara.

## **Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:**

### **Sëmundjet vaksinëparandaluese**

Gjatë muajit mars 2026, nga laboratorit i Mikrobiologjisë në IKShPK janë raportuar 3 raste pozitive me Pertussis dhe 1 rast pozitiv me Parotit. Rastet e konfirmuara me Pertussis sipas komunave: Prishtinë, Fushë Kosovë dhe. Sipas grupmoshës, 2 raste i përkasin grupmoshës 1–4 vjeç, ndërsa 1 rast grupmoshës 10–18 vjeç ku sipas hulumtimit epidemiologjik vetëm një nga rastet ka status të rregullt vaksinal. Rasti i konfirmuar me Parotit është nga komuna e Podujevës, grupmoshë 1–4 vjeç, dhe status jo të rregullt vaksinal.

### **Zoonozat dhe sëmundjet transmise**

Gjatë muajit mars, nga laboratorit i Mikrobiologjisë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar 2 raste me Brucelozë. Rastet pozitive sipas komunave: një rast nga Peja dhe një rast nga Prizreni dhe të dy rastet i përkasin gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës: 40–49 vjeç (1 rast) dhe 50–59 vjeç (1 rast) Sipas hulumtimit epidemiologjik rezultoi se rasti (nga Peja) ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë me kafshë (dele), duke qenë fermer dhe duke mbajtur në pronësi tufë prej 20 krerësh, ndërsa rasti nga Prizreni mohon kontaktin direkt me kafshë dhe deklaroi se konsumon produkte të qumështit nga tregu dhe furnizues lokal. Për rastet janë njoftuar institucionet relevante me qëllim të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjes.

Gjithashtu nga ky grup i sëmundjeve gjatë muajit mars, është raportuar një rast me Echinococcus, nga komuna e Prizrenit, i gjinisë femërore dhe grup moshë 40-49 vjeç.

### **Sindroma meningjeale**

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar gjithsej 17 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 1.06/100,000 banorë), prej tyre 13 raste me Meningitis acuta, 1 rast me Meningitis acuta purulenta dhe 3 raste me Meningoencephalitis acuta. Numri i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak (mars, 2025), kur ishin raportuar 13 raste (Inc. 0.73/100,000 banorë). Numri më i madh i rasteve të raportuara sipas komunave është regjistruar në Prishtinë me 4 raste Mitrovica me 2 raste, dhe me nga 1 rast janë në komunat Vushtrri, Prizren, Pejë, Shtime, Malishevë, Lipjan. Obiliq, Suharekë, Kacanik dhe Skenderaj. Sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshës, gjatë kësaj periudhe numri më i madh i rasteve është raportuar në grup-moshën 0–9 vjeç, me 8 raste (47.1%), grup-mosha 10–19 vjeç me 6 raste (35.3%), 60–69 vjeç me 2 raste (11.8%) dhe me 1 rast 70–79 vjeç (5.8%). Ndërsa nuk ka raportime nga grup-moshat e tjera. Sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë, 35.3% (6 raste) i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 64.7% (11 raste) i takojnë gjinisë mashkullore. Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK përmes sistemit MedLIS, si dhe në laboratorin mikrobiologjik të Klinikës Infektive, janë identifikuar disa shkaktarë viralë në lëngun cerebrospinal (LCS). Gjithsej janë raportuar 2 raste me izolime pozitive. Shkaktarët viralë të identifikuar janë: 1 rast me Human Herpes Virus 7 (HHV-7) dhe 1 rast me Human Enterovirus. Ndërsa shkaktarët bakterialë nuk janë identifikuar. Nga rastet e raportuara gjatë muajit mars 2026, nuk ka raportime për vdekje.

### **Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim**

Gjatë muajit mars 2026, nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar numër i konsiderueshëm i rasteve me gjithsej 3, 565 raste të regjistruara. Dominon diarreja akute, e cila përbën shumicën e rasteve me 3,455 raste të raportuara apo 215.6/100,000 banorë. Gjithashtu janë raportuar 96 raste të helmimit me ushqim dhe 14 raste me dg. Gastroenterokolit ac. Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe Kl. Infektive janë raportuar: 6 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Skënderaj, dhe me nga një rast në komunat Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Kamenicë. Sipas grupmoshave: 4 raste janë të grupmoshës 0–9 vjeç dhe 2 raste te grupmoshës 10-19 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 4 raste janë të gjinisë femërore dhe 2 raste të gjinisë mashkullore. Sipas të dhënave epidemiologjike, rastet janë ushqyer kryesisht në shtëpi dhe janë të kyqura në ujësjellës dhe kanalizim; 13 raste me Giardia lamblia, prej të cilave sipas komunave:

me nga 3 raste janë komunat Prizren dhe Pejë, me nga 2 raste janë komunat Rahovec dhe Gjakovë, dhe me nga një rast komunat Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Klinë. Sipas grupmohave: 6 raste janë të grupmohës 0-9 vjeç, 2 raste të grupmohës 30-39 vjeç, 4 raste të grupmohës 20-29 vjeç dhe një rast i grupmohës mbi 65 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë: 7 raste të gjinisë mashkullore dhe 6 raste të gjinisë femërore; 6 raste me Adenovirus, prej te cilave me nga një rast janë komunat; Prishtinë, Prizren, Rahovec, Mitrovicë, Pejë dhe Glllogoc. Rastet i takojnë grupmohave 0-9 vjeç. Ndërsa sipas gjinisë 4 raste i takojnë gjinisë femërore dhe një rast i gjinisë mashkullore; 2 raste me Salmonella enteridis prej të cilave 1 rast nga komuna e Prishtinës dhe 1 rast nga komuna e Gjakovës. Sipas grupmohës kemi 1 rast i grupmohës 20-29 vjeç dhe 1 rast i grupmohës 30-39 vjeç. Sipas gjinisë të 2 rastet janë të gjinisë mashkullore. Sipas hulumtimit epidemiologjik rastet kanë konsumuar ushqim në shtëpi dhe mohojnë raste të tjera me lidhshmëri epidemiologjike. Janë të kyqur në ujësjellës dhe kanalizim; 3 raste me Clostridium difficile prej të cilave 2 raste nga komuna e Prishtinës dhe 1 rast nga komuna e Glllogocit. Sipas moshës 2 raste i takojnë grupmohës 0-9 vjeç dhe 1 rast i grupmohës 40-49 vjeç. Shenjat dhe simptomat e tyre kanë qenë temperature, ethe, vjellje, barkëqitje ujore për disa ditë. Janë të kyqur në ujësjellës dhe kanalizim. Anëtarët e tjerë të familjes nuk kanë shenja dhe simptoma; 1 rast me Campylobacter nga komuna e Glllogocit i grupmohës 30-39 vjeç, i gjinisë mashkullore; 2 raste me Enterovirus prej te cileve nje rast nga komuna e Prishtinës dhe një rast nga komuna e Ferizajit. Rastet i përkasin grupmohës 10-19 vjeç dhe janë të gjinisë mashkullore.

### **Sëmundjet/Infeksionet respiratore**

Gjatë muajit mars 2026, janë testuar gjithsej 347 mostra të dyshimta për Influcencë, COVID-19, RSV dhe patogjenët e tjerë respiratorë, të përzgjedhura nga qendrat sentinel. Nga mostrat e testuara është konfirmuar 1 rast me Influcencën A, (pozitivitet prej 0.29%), 1 rast me SARS-CoV-2, derisa nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 21 (6.05%) mostra pozitive me RSV, 64 (18.44%) mostra pozitive me Human Rhinovirus, 18 (5.19%) mostra pozitive në Human Adenovirus, 42 (12.10%) mostra pozitive në Metapneumovirus dhe 13 (3.75%) mostra pozitive në Human Parainfluenza virus. Mbikëqyrja me Influcencë, COVID-19 dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC, WHO për sezonën 2025/2026 si dhe Buletinin javor me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike.

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu janë raportuar 39 raste me SARI (Inc.2.19/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (19 raste) vërehet rritje e ndjeshme e numrit të rasteve. Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (15 raste), Fushë Kosovë (5 raste), Ferizaj (5 raste), Gjilan (3 raste), drenas (2 raste), Kacanik (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Lipjan, Malishevë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Suharekë dhe Vushtrri. ). Sipas gjinisë, 25 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 14 gjinisë femërore dhe sipas grup moshës: 0-4 vjeç (13 raste), mbi 65 vjeç (8 raste), 51-64 vjeç (7 raste), 5-14 vjeç (5 raste), 15-34 vjeç (3 raste) dhe 35-50 vjeç (3 raste. Nga të gjitha rastet SARI, 2 apo 5.1% prej tyre ishin të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Sipas shkaktarëve të konfirmuara rezultuan, 11 mostra pozitive në Virusin Sincicial (RSV), 5 mostra pozitive në Human Metapneumovirus (MPV), 4 mostra pozitive në Human Rhinovirus dhe 1 mostër pozitive në Human Adenovirus. Gjatë muajit mars 2026, janë raportuar 3 raste të vdekjes nga SARI (CFR= 7.7%). sipas komunave : Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Shtime dhe të gjitha rastet i takojnë grup-moshës 65+ (3 raste) me sëmundje përcjellëse.

### **Ecuria me Tuberkuloz**

Përmes Sistemit elektronik të sëmundjeve ngjitëse (SMSN), gjatë muajit mars 2026, janë raportuar 51 raste me Tuberkuloz apo 3.18 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Mitrovicë (8 raste), Ferizaj dhe Vushtrri me nga (7 raste), Kaçanik (6 raste), me nga (4 raste) komunat: Prishtinë dhe Rahovec, me (3 raste) Gjakovë, me nga (2 raste) komunat: Lipjan, Pejë dhe Viti, me nga 1 rast: Fushë Kosovë, Kamenicë, Klinë, Malishevë, Prizren dhe Skenderaj. Prej 51 rasteve të raportuara, 35 (68.6%) janë raste pulmonare dhe forma ekstra-pulmonare 16 (31.4%). Sa i përket grup-moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup-moshat më të prekura janë 20-24 vjeç, 45-49 vjeç, 60-64 vjeç, 65-69 vjeç dhe 75-79 vjeç me nga (6 raste), grupmoshat 30-34 vjeç, 50-54 vjeç dhe 55-59 vjeç me nga (3 raste), 35-39 vjeç dhe 40-44 vjeç me nga (2 raste), kurse grup-moshat 10-14 vjeç, 15-19 vjeç, 25-29 vjeç, 5-9 vjeç dhe 85-89 vjeç me nga (1 rast). Sipas gjinisë, rezulton se gjinia mashkullore me 56.9% (29 raste), ndërsa 43.1% (22 raste) i takojnë gjinisë femërore.

## **Rastet me HIV/AIDS/IST**

Gjatë muajit mars 2026, janë raportuar 3 raste me HIV/AIDS, rastet janë të gjinisë mashkullore dhe sipas komunave: Fushë Kosovë, Rahovec dhe Gjakovë. Një rast i takon grup moshës 25-34 vjeç, një rast 35-44 dhe një grup moshës 45-54 vjeç. Të 3 rastet janë raportuar përmes MedLis nga mikrobiologjia dhe përmes SMSN nga Klinika Infektive.

## **Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST)**

Gjatë muajit mars 2026 janë raportuar gjithsej 14 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Pejë 4 raste, Podujevë 2 raste, Glllogoc 2 raste, Fushë Kosovë 1 rast, Istog 1 rast, Prizren 1 rast, Suharekë 1 rast, Vushtrri 1 rast dhe Malishevë 1 rast. Sipas diagnozës: Chlamydia 4 raste, Condyloma 7 raste, Sifiliz 1 rast dhe Gonorrhea 1 rast. Sipas gjinisë: 7 raste (50%) i takojnë gjinisë femërore dhe 7 raste (50%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 25-49 vjeç 9 raste (64%), 15-24 vjeç 3 raste (21%), dhe 50+ 2 raste (15%).

## **Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C**

Gjatë muajit mars 2026 është raportuar 1 (një) rast me Dg. Hepatit akut B. Rasti është nga komuna e Istogut, i gjinisë mashkullore (37 vjeç). Sa i përket Hepatitit akut C, gjatë muajit mars, 2026 është raportuar 1 (një) rast, nga komuna e Prizrenit, i gjinisë mashkullore (63 vjeç).

## Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, mars 2026

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, mars _2026																														
SËMUNDJA	KOMUNA	Pneumonia /ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Variçella	Influenca A	RSV	COVID-19	Sindroma meningjeale			Parotitis epidemica	Pertussis	Hepatitac. B	Hepatitac. C	Helmimet me ushqim	Gastroenterokolitet	Bruceloz a	Salmonelloza	Rotavirus	Cl.difficile	IST	HIV	TB	Giardia	Infeksionet streptokok sike të gr. A	Sëm.tjera ngjitëse	Totali	
										Meningjët serosa	Meningjët purulent	Meningoencephalit ac.																		
DEÇAN		12		174	51	21											7												265	
DRAGASH		4		51	32																								87	
DRENAS		2	2	32	30	6															1	1	2						76	
F. KOSOVË		7	5	74	59	3		2				1					5						1	1	1	1			160	
FERIZAJ		22	5	267	174	25		3										8			2				7		2	1	516	
GJAKOVË		10		125	61	72											2	3		1				1	3	2	18		298	
GJILAN		20	2	124	141	6																							293	
GRAÇANICË																													0	
H. I ELEZIT		1		28	15	7		1																					52	
ISTOG		8		78	31										1		5						1						124	
JUNIK				11	3	3											1										1		19	
KAÇANIK		4	2	36	22	9		1			1							2							6				83	
KAMENICË				247	61	3															1				1				313	
KLINË		23		130	54	21											1								1	1		2	233	
KLLOKOT																													0	
LEPOSAVIQ																													0	
LIPJAN			1	67	21						1		1													2			93	
MALISHEVË		0	1	83	51	9		1			1							1					1		1			1	150	
MAMUSHË		0		4	22	15																							41	
MITROVICË		73		475	388	21											1					1			8		8		977	
MITROVICË E VERIUT																													0	
N. BËRDË				12	11	0																								23
OBILIQ			1	78	72	17		1			1						2												172	
PARTESH																													0	
PEJË		48	1	642	274	13											45		1		1			4		2	3	3	1038	
PODUJEVË		10	1	143	106	22		2				1												2					287	
PRISHTINË		1032	15	566	1035	139	1	4	1	3		1		1			10			1	3	2			4	1		2819		
PRIZREN		2	1	419	297	29		1			1			1		1				1		2	1		1	3	2	7	770	
RAHOVEC				19	23	1		1														1			1	4	2		52	
RANILLUG																														0
SHTËRPCE																														0
SHTIME		17		305	43	7					1																		373	
SKËNDERAJ				83	54	15								1												1		1	160	
SUHAREKË		5	1	384	188	11		1			1												1						592	
VITI				104	74	23																				2			203	
VUSHTRRI			1	24	62	9		3			1						14						1			7			122	
Z. POTOK																														0
ZVEÇAN																														0
BURGU I LIPJANIT																														0
PA ADRESË																														0
TOTALI		1300	39	4785	3455	507	1	21	1	13	1	3	2	3	1	1	96	14	2	2	14	3	14	3	51	13	23	23	10391	

\*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

### **3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, MARS 2026**

Rastet e spitalizuara në numër më të madh nga sëmundjet ngjitëse janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respirator, të pasuara me diarë akute dhe gastroenterokolite. Vetëm një pjesë e këtyre rasteve kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit, ndërsa pjesa tjetër raportohet bazuar në diagnozën klinike (shih Tabela 3).

**Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatrië dhe spitalet e përgjithshme, mars 2026**

<b>Sëmundja/Diagnoza klinike</b>	<b>Rastet</b>
Pneumonia /ARI	140
SARI	39
Sindroma meningjeale	17
Helmimet me ushqim	9
Diarea akute dhe gastroenterocolite	162
Status febrilis	11
Exanthema	5
Mononucleosis	4
Erysipela	1
<b>Gjithsej</b>	<b>383</b>

### **4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT MARS 2026**

Gjate muajit mars 2026, nuk është raportuar asnjë epidemi.

## 5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 28 komuna ose 73.68% (28/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klinë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok. Përveq komunës së Klinës, të gjitha komunitat e cekura më lartë, gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.

**Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, mars 2026**

KOMUNA	KOPJE FIZIKE									SMSN													
	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucio net Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucio net Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej		
DEÇAN							157	18		175								25				25	
DRAGASH							45	22		67								1				1	
DRENAS							59			59								41	12	3		56	
F. KOSOVË							7			7								95	29	69		193	
FERIZAJ	6					175	58	82		321	1				28			47	61	7		144	
GJAKOVË										0	37					31			164	72			304
GJILAN						94	53	134		281	16							38	54			108	
GRAÇANICË										0												0	
H. I ELEZIT							44			44								5				5	
ISTOG							26	36		62								26	3			29	
JUNIK							5			5								20				20	
KAÇANIK							42			42								32				32	
KAMENICË							76	105		181								12	12			24	
KLINË							179		28	207												0	
KLOKOT										0												0	
LEPOSAVIQ										0												0	
LIPJAN										0								61	0	29		90	
MALISHEVË										0								142	1			143	
MAMUSHË							42			42								24				24	
MITROVICË	314						284	243	18	859								22				22	
MITROVICË V.										0												0	
N. BËRDË							23			23								2				2	
OBILIQ										0								117	44			161	
PARTESH										0												0	
PEJË	2					3	143	406	187	741	182							41				223	
PODUJEVË							276	11	16	303								92	13	8		113	
PRISHTINË		103	115				81	994	348	1641		61	20	7	6	5	17	28	1122	5		1271	
PRIZREN	24					19	214	397	73	727	42					25		66	159			292	
RAHOVEC										0						6		25	14	4		49	
RANILLUG										0												0	
SHTËRPCE										0												0	
SHTIME	26						65	182		273								29				29	
SKËNDERAJ							78	41		119								36				36	
SUHAREKË						24	190	105	23	342						2		69	2			73	
VITI							129	57		186								68	36			104	
VUSHTRRI										0	29							12	70			111	
Z. POTOK										0												0	
ZVEÇAN										0												0	
Gjithsej	372	103	115	0	0	315	2276	2833	693	6707	307	61	20	7	6	97	17	1340	1704	125		3684	

Gjatë muajit mars 2026, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) janë raportuar gjithsej 3,684 raste me sëmundje ngjitëse dhe krahasuar me numrin e përgjithshëm të rasteve të raportuara (10,391) i shprehur në përqindje (35.45%). Gjatë muajit mars 2026 vërehet një rritje e lehtë prej 2% e numrit të rasteve të raportuara përmes SMSN, krahasuar me muajin paraprak, shkurt 2026. (Tabela 4).

## 6. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, MARS 2026

### Fruthi

Në janar 2026, 28 vende të BE/ZEE raportuan të dhëna për fruthin, ku 12 prej tyre raportuan 173 raste, ndërsa 16 vende nuk raportuan asnjë rast. Numri i rasteve ka shënuar rritje krahasuar me muajin paraprak. Rastet me numër më të lartë janë raportuar në Itali, Spanjë dhe Francë. Gjatë periudhës 1 shkurt 2025 – 31 janar 2026 janë raportuar gjithsej 6, 037 raste, ku rreth 80% janë konfirmuar laboratorikisht. Pjesa më e madhe e rasteve është raportuar tek fëmijët nën pesë vjeç dhe tek individët mbi 15 vjeç. Nga rastet me informacion për vaksinimin, rreth 78% kanë qenë të pavaksinuar. Janë raportuar gjithashtu shpërthime dhe klasterë në disa vende evropiane, si dhe rritje të rasteve në rajone të tjera si SHBA, Kanada dhe Afrikë. Sipas vlerësimit të ECDC, edhe pse shumë raste janë rezultat i transmetimit lokal, rastet e lidhura me udhëtimet vazhdojnë të raportohen. Rreziku mbetet i lidhur me mbulimin e pamjaftueshëm të vaksinimit dhe lëvizjet e popullsisë si dhe rekomandohet rritja e mbulimit me vaksinim dhe fuqizimi i mbikëqyrjes epidemiologjike.

### Sëmundja invazive meningokoksike – Angli

Autoritetet shëndetësore në Mbretërinë e Bashkuar, përmes UK Health Security Agency (UKHSA), kanë konfirmuar një shpërthim lokal të sëmundjes invazive meningokoksike në zonën e Canterbury, Kent, që nga 13 mars 2026 ku janë raportuar 13 raste të konfirmuara të infeksionit me *Neisseria meningitidis*, nga të cilët 2 persona kanë ndërruar jetë dhe 11 janë të hospitalizuar në gjendje serioze. Rastet përfshijnë një student të “University of Kent” dhe një nxënëse të shkollës së mesme “Mbretëresha Elizabeta” në Faversham. Rastet e tjera përfshijnë studentë dhe të rinj që kanë kërkuar trajtim urgjent. Hulumtimi epidemiologjike ka identifikuar se disa prej të infektuarve kanë qenë të pranishëm në klubin e natës “Club Chemistry” në Canterbury më 5, 6 dhe 7 mars 2026, para shfaqjes së simptomave. Bazuar në këtë lidhje, UKHSA u ka bërë thirrje të gjithë personave që kanë frekuentuar këtë klub në këto data të paraqiten për trajtim profilaktik me antibiotikë. Autoritetet po bashkëpunojnë me menaxhmentin e klubit, universitetet dhe shërbimet shëndetësore për gjurmimin e kontakteve. Manifestimet klinike përfshijnë temperaturë të lartë, dhimbje koke të forta, rigjeditet të qafës, simptoma të septikemisë dhe çrregullime neurologjike serioze. Sëmundja mund të përparojë shpejt dhe të jetë kërcënuese për jetën nëse nuk trajtohet menjëherë. UKHSA ka njoftuar mbi 30, 000 persona në zonën e Canterbury dhe ka ofruar antibiotikë profilaktikë dhe udhëzime për gjurmimin e kontakteve si dhe identifikimin e shtamit bakterial dhe kuptimin e modelit të transmetimit të sëmundjes.

### Virusi Chikungunya

Që nga nëntori 2025, më shumë se 110 raste të virusit chikungunya janë raportuar nga 13 vende të BE/ZEE tek udhëtarët që janë kthyer nga Seychelles (Oqeani Indian). Ky numër paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me muajt e mëparshëm të vitit 2025, ndërsa në vitet paraprake nuk janë raportuar raste të tilla të lidhura me këtë destinacion. Shfaqja e virusit chikungunya në Seychelles lidhet me përhapjen më të gjerë rajonale në Oqeanin Indian, ku gjatë vitit 2025 është raportuar edhe një shpërthim i madh në Réunion. Sipas autoriteteve lokale shëndetësore, virusi chikungunya aktualisht është më i përhapur krahasuar me arboviruset e tjera që qarkullojnë në Seychelles. Sipas vlerësimit të ECDC, probabiliteti i infektimit për udhëtarët që vizitojnë këtë vend konsiderohet i lartë. Duke qenë se periudha me fluksin më të madh të udhëtimeve është nga shkurti deri në prill, rekomandohet forcimi i komunikimit me udhëtarët dhe klinikat e mjekësisë së udhëtimit për rritjen e masave parandaluese, ndërsa vaksinimi mund të merret në konsideratë sipas rekomandimeve kombëtare. Megjithatë, mundësia e transmetimit të mëtejshëm në Evropën kontinentale pas importimit të rasteve konsiderohet e ulët, pasi kushtet mjedisore aktualisht nuk janë të favorshme për aktivitetin e mushkonjave Aedes.

### Monitorimi i grumbullimeve masive – Lojërat olimpike dhe paraolimpike dimërore, Milano Cortina 2026

Sipas të dhënave të përditësuara deri më 20 mars 2026, nuk janë identifikuar ngjarje madhore të shëndetit publik të lidhura me sëmundje ngjitëse gjatë zhvillimit të Lojërave Olimpike dhe Paraolimpike Dimërore Milano Cortina 2026. Edhe gjatë zhvillimit të Lojërave Paraolimpike (6–15 mars), nuk janë raportuar ngjarje të rëndësishme epidemiologjike mes pjesëmarrësve. Gjatë Lojërave Olimpike (4–22 shkurt), janë raportuar vetëm disa shpërthime të kufizuara të sëmundjeve gastrointestinale dhe sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) mes atletëve në Fshatin Olimpik, ndërsa nuk është evidentuar transmetim i sëmundjeve ngjitëse tek spektatorët. Sipas vlerësimit të ECDC, probabiliteti i infektimit për qytetarët e BE/ZEE gjatë këtyre ngjarjeve konsiderohet i ulët, nëse respektohen masat parandaluese si vaksinimi sipas kalendarit kombëtar, higjiena e duarve dhe ushqimit, etika respiratore dhe vetë-izolimi në rast të simptomave.

## **Situata epidemiologjike e viruseve respiratore**

Në nivel të BE/ZEE, aktiviteti i viruseve respiratore vazhdon të monitorohet përmes sistemeve të mbikëqyrjes. Të dhënat tregojnë se qarkullimi i viruseve respiratore mbetet aktiv, me dominim të virusit të gripit, ndërsa SARS-CoV-2 vazhdon të qarkullojë në nivele të ulëta dhe stabile. Nga mbikëqyrja virologjike në kujdesin parësor dhe spitalor (ILI/ARI dhe SARI), gripi vazhdon të jetë virusi dominues, kryesisht i tipit A, ndërsa RSV kontribuon në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, veçanërisht tek fëmijët. Të dhënat tregojnë gjithashtu një variacion ndërmjet vendeve sa i përket intensitetit dhe shpërndarjes së infeksioneve respiratore. Sipas vlerësimit të ECDC, aktiviteti i viruseve respiratore mbetet në nivele të moderuara me tendencë të ndryshme ndërmjet vendeve, ndërsa monitorimi i vazhdueshëm mbetet thelbësor për vlerësimin e barrës së sëmundjes.

### **MPOX**

Virusi i mpox (kladet I dhe II) vazhdon të qarkullojë në shumë vende në nivel global. Në BE/ZEE, rastet e kladit I vazhdojnë të raportohen, me një numër total prej 264 rastesh që nga gushti 2024 deri më 12 mars 2026, ndërsa gjatë muajit shkurt është vërejtur një ulje e lehtë krahasuar me muajt paraprakë. Shumica e rasteve në BE/ZEE janë raportuar tek meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj, ku transmetimi ndodh kryesisht përmes kontaktit të ngushtë seksual. Është evidentuar gjithashtu transmetim i kufizuar sekondar brenda familjeve dhe në disa rate pa histori udhëtimi, duke sugjeruar transmetim lokal. Në Ballkanin Perëndimor janë raportuar raste të konfirmuara në disa vende, përfshirë edhe Kosovën, ndërsa Turkiye ka raportuar dhjetëra raste. Sipas vlerësimit të ECDC, rreziku për infeksion me kladin Ib konsiderohet mesatar për meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj dhe i ulët për popullatën e përgjithshme. Rreziku për kladin Iib mbetet i ulët. Rekomandohet forcimi i vaksinimit për grupet me rrezik, rritja e testimit, gjurmimi i kontakteve dhe komunikimi i rrezikut.

### **Ethet Denge**

Në vitin 2026, disa vende të BE/ZEE kanë raportuar rritje të rasteve të importuara të Dengue tek udhëtarët që kthehen nga Maldivet. Janë raportuar të paktën 46 raste në katër vende, duke reflektuar vazhdimësinë e rritjes së vërejtur gjatë vitit 2025. Në Maldivet është raportuar një rritje e pazakontë e rasteve, me 631 raste në janar 2026 krahasuar me 72 raste në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Sipas vlerësimit të ECDC, probabiliteti i infektimit për udhëtarët konsiderohet mesatar, ndërsa rreziku i transmetimit të mëtejshëm në Evropë mbetet i ulët për shkak të kushteve jo të favorshme për vektorët.

### **Gripi i shpendëve A(H5N1)**

Në mars 2026 është raportuar një rast i ri tek njeriu i infeksionit me virusin e gripit të shpendëve A(H5N1) në Kamboxhia. Rasti lidhet me kontakt me shpendë të sëmurë ose të ngordhur. Që nga viti 2003, globalisht janë raportuar 996 raste tek njerëzit, përfshirë 477 vdekje. Deri më tani nuk është dokumentuar transmetim i qëndrueshëm nga njeriu te njeriu. Sipas vlerësimit të ECDC, rreziku për popullatën e përgjithshme në BE/ZEE mbetet i ulët, ndërsa ekspozimi ndaj shpendëve të infektuar konsiderohet faktori kryesor i rrezikut.

## **7. REKOMANDIMET**

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

---

**INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË**

**PUBLIKE TË KOSOVËS**

**Departamenti i Epidemiologjisë**

**Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000**

**WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>**

**E-mail: [QOE.IKSHP@rks-gov.net](mailto:QOE.IKSHP@rks-gov.net)**

**Telefoni+38338 541432**

---

